



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKËS/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY
 Nr. Prot.
 Br. Prot.
 Prot No. 01-474/hs
 Data
 Datum
 Date 10-12-2015
 20/DPK
 09

DATË/A:	10/12/2015	PRISHTINË
REFERENC-Ë:	AKK – DPK - DPKPP – 03-03/4498/15	
PËR/ZA/TO:	z. Maja POPOVIQ Menaxhere e Prokurimit - Komuna Zveçan	
CC:	z. Vuçina JANKOVIQ Kryetar Komune – Komuna Zveçan	
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Asfaltimi i rrugës lokale në Zhitkovic (Denoviç – Trafostacioni)"	

E nderuar znj. POPOVIQ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me Tenderin: "Asfaltimi i rrugës lokale në Zhitkovic (Denoviç – Trafostacioni)" me numër prokurimi: 646-16026/15/041/521, Agjencia kundër Korruptionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: "Asfaltimi i rrugës lokale në Zhitkovic (Denoviç – Trafostacioni)" me numër prokurimi: 646-16026/15/041/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues, Komuna e Zveçanit, bazuar në nevojat e saja për të realizuar punë, gjegjësisht asfaltim në rrugët lokale ka paraparë aktivitet prokurimi me procedurë të hapur, i cili është publikuar në KRRPP më 13/11/2015.

Agjencia kundër Korrupsion ka identifikuar se Komuna e Zveçanit, si autoritet kontraktues gjatë përpilimit të dosjes të tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje ligjore të legjislacionit për Prokurimit Publik. Për këtë projekt, komuna e Zveçanit, pos tjerash nuk ka dëshmuar se posedon “*Projekt Ekzekutiv*” me të cilin do ti mundësohej paraqitja e dizajnit grafik të të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierisë të punëve të kërkuara. Bazuar në projektin ekzekutiv, autoriteti kontraktues pastaj përgatit specifikat teknik të dosjes së tenderit. Me një fjalë projekti ekzekutiv nënkuption përshkrimin e strukturës së projektit.

Në “*Njoftim për Kontratë*” në gjuhën shqipe, tek pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, autoriteti kontraktues ka kërkuar që: “*Operatori ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi bindëse tek Tenderuesi se qarkullimi i tij i përgjithshëm në periudhën (2012-2014) ishte jo më pak se 100,000.00 €, dhe gjithashtu ka përvojë në punën me komunat veriore të Kosovës*”. Në versionin e gjuhës serbe për dallim nga gjuha shqipe që janë kërkuar 100,000.00 €, në versionin e gjuhës serbe kjo shumë është 160,000.00 €. Më tej në atë paragraf, përcaktimi i kriterit të përvojës së punës në Komunat e Veriut të Kosovës është kriter diskriminues dhe është kërkuar vetëm në versionin e gjuhës shqipe. Për dallim në mos përputhjen e vlerës qarkulluese për tre vitet e fundit të cilat nuk janë përputhur, shuma e caktuar në asnjërin rast nuk tejkalon vlerën e parashikuar sipas ligjit, ndërsa, përcaktimi i përvojës vetëm në një regjion është kriter diskriminues. Si i tillë favorizon një numër operatorësh ekonomik të cilët kanë realizuar punë në komunat e cekura dhe në të njëjtën kohë diskriminon ata të cilët nuk kanë një përvojë të tillë në ato komuna. Formulimet e tilla po ashtu nuk i lënë hapësirë të mjaftueshme edhe ekonomisë së lirë të tregut.

Në “*Njoftim për Kontratë*” në gjuhën serbe, tek pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, autoriteti kontraktues ka kërkuar që: “*Operatori ekonomik patjetër duhet të ofroj dëshmi që ka realizuar punë të njëjtë ose të ngjashme në tre vitet e fundit, së paku tre kontrata me një vlerë minimale të kontratave prej 160,000.00 €*”. Përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, por nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës

Në versionet e dokumentacionit në gjuhën shqipe dhe serbe ka shume mospërputhje në kriteret e kërkua dhe si i tillë ky fakt ka bërë që operatorët ekonomik të caktuar të mos ofertojnë dhe në këtë mënyrë të mos merret çmimi më i mirë që është parakusht që siguron vlerën për para. Pra, kur autoriteti kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njostimit të kontratës, autoriteti kontraktues do të përgatisë një njostim të kontratës në gjuhët e cekura dhe do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njostimi të kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përbajnë informata materialisht identike.

Kjo mospërputhje në versionet e njostimit për kontratë dhe kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktues konsiderojmë se kanë bërë që vetëm tre operator ekonomik të térheqin dosjen e tenderit dhe vetëm dy prej tyre të ofertojnë. Bazuar në “Raporti i Vlerësimit të Ofertave” dhe “Njostim për dhënie të Kontratës”, dy nga ofertuesit që kanë konkurruar për këtë aktivitet janë klasifikuar si të përgjegjshëm dhe me këtë rast grupei i operatorëve ekonomik PTP “RAD” nga Zveçani dhe NNT “ABC” nga Podujeva është rekomanduar për dhënie të kontratës.

Agjencia kundër Korrupsion pas marrjes së dokumentacionit nga Komuna Zveçan, ka analizuar, ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat e dy ofertuesve dhe ka konstatuar se asnjëri nga grupet e operatorëve ekonomik 1). PTP “RAD” & NNT “ABC”, dhe 2). PTP “METAL” dhe “Europa Partners” shpk nuk janë të përgjegjshëm. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njostimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatori ekonomik NNT “ABC”, anëtar i grupit në grupin e operatorëve që është rekomanduar për kontratë ka paraqitur menaxherin e projekteve me diplomë “bachelor” të ndërtimtarisë, derisa në “*Dosjen e Tenderit*” është kërkuar inxhinier i ndërtimtarisë. Personi i caktuar për menaxher, nuk e ka titullin inxhinier sipas dokumentacionit që ka ofertuar. Po ashtu për stafin udhëheqës është kërkuar që të dëshmohen me listën e ATK-së për pagesën që ka pranuar menaxheri i projekteve nga operatori ekonomik për tremujorin e parë të vitit 2015. NNT “ABC” ka ofruar vërtetimin nga ATK, i cili shpalos faktin se për tremujorin e parë të këtij viti nuk i ka paguar pagë menaxherit të caktuar për projektin në fjalë. Në këtë ofertë të grupit ekonomik janë paraqitur shumë dokumente të cilat janë të pa lexueshme dhe pa validitet. Operatori ekonomik PTP “RAD” ka prezantuar një listë me 24 kontrata të realizuara me komunat paralele të Serbisë në Kosovë të cilat operojnë ilegal në Republikën e Kosovës. Komuna e Zveçanit si autoritet kontraktues është dashur ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të mos pranuar referenca të tillë me që projekti do të realizohet nga buxheti i Kosovës ndërsa për punët që operatori ekonomik PTP “RAD” ka realizuar më herët me struktura të tillë nuk ka dhënë kontribut në buxhetin e shtetit nga i cili financohet komuna.



Grupi i dytë i operatorëve ekonomik PTP “METAL” dhe “Europa Partners” shpk që kanë ofertuar në këtë aktivitet ka paraqitur po ashtu menaxherin e projektit, i cili sikur në rastin e parë nuk është ofruar dëshmi nga ATK për pagesat që i ka bërë operatori ekonomik në tremujorin e parë të këtij viti. Në këtë ofertë të grupit të operatorëve ekonomik janë paraqitur shumë dokumente të cilat janë të pa lexueshme dhe pa validitet. Lideri i grupit PTP “METAL” po ashtu ka paraqitur pajisje dhe mjete të cilat janë me tabela jo legale në Kosovë.

Autoriteti kontraktues gjatë procesit të prokurimit duhet të sigurohet që ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk do të ekzekutojë asnjë aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që minimizon apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrëthanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit; Nenin 28 Specifikimet teknike; Nenin 40 Njoftimi i Konratës; Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik; Projekti Ekzekutiv i Udhëzimit administrativ Nr.01/2014 të KRPP-së; si dhe Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të marr hapat e nevojshëm për anulimin e “Njoftim për Dhënie të Konratës” në mënyrë që aktiviteti i prokurimit mos të ecë tutje pas shkeljes së ligjit të Prokurimit Publik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

